



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.
2-D/DPK	01-4552/15
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Dat.
02	02.12.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2781/15, për zyrtarin e lartë z.Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2781/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është identifikuar se zyrtari i lartë, z. Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, ka të regjistruar dhe figuron si person i autorizuar në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.09.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Pjeter Coli, ka ardhur në zyrat e AKK-së ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me faktet dhe situatën në të cilën gjendet, në takim z. Coli, na ka njoftuar me gjerësisht

me situatën, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar për këtë çështje dhe se biznesi N.T.P “Simoni” nuk zhvillon aktivitet dhe është zotuar se brenda afatit ligjorë do të sjell dëshmitë për ndryshimet në udhëheqjen e këtij biznesi dhe do fillojë procedurat për shuarjen e këtij biznesi pasi që nuk zhvillon asnjë aktivitet biznesor.

Me datën 30.11.2015, kemi pranuar dokumentin nga z. Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës, ku dëshmohet nga dokumenti zyrtar i lëshuar nga ARBK-ja, se z. Pjetër Coli nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin me nr.70516136 dhe emër “N.T.P Simoni”.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga, z. Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës, duke bërë ndryshimet e kërkuara sipas ligjit në fuqi në biznesin e tij privat dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, z. Pjetër Coli, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klinës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

